



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.09.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 12 shtator 2018.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza II” (*komision për dhënie mendimi*).
Miratimi i projektligjit.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Kejdi Mehmetaj, Shezai Rrokaj, Nora Malaj.

Të ftuar:

Gentian Keri – sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë,
Alfred Bundo – drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë,
Ardian Islami – përgjegjës sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë,
Brikena Jazxhi – specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Për mbledhjen e sotme ne caktuam një orar për të cilin kishim rënë dakord, por që u shty për arsye se grupi i punës për këtë projektligj ka qenë në disa komisione. Sot do të diskutojmë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main, për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza II”.

Të ftuar kemi: Gentian Keri, sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; Alfred Bundo, drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ardian Islami, përgjegjës sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë; Brikena Jazxhi, specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Arbër Mazniku, nënkryetar i Bashkisë së Tiranës, i cili ende nuk ka mbërritur.

Ky projektligj është i ndarë në dy faza dhe kjo është faza e dytë. Në fazën e parë kemi pasur diskutime të zjarrta për këtë projektligj, 1 vit më parë. Pra bëhet fjalë për një grand, i cili ndahet në dy pjesë dhe kjo pjesë është sa 1/3-ta e gjithë sasisë së parave grand që jep qeveria gjermane për të stabilizuar gjendjen e energjisë në konviktet e kampusit universitar. Megjithatë, do të ishim shumë të lumtur nëse do të na thoni dy fjalë, zoti Keri, për këtë projektligj.

Ne jemi komision që japim mendim për këtë projektligj dhe do të na duhet ta miratojmë në parim, nen për nen dhe në tërësi. Përveç kësaj kemi rënë dakord nga mbledhja e kaluar që relator për këtë projektligj do të jetë zoti Ismet Beqiraj.

Zoti Keri, fjala është për ju.

Gentian Keri – Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar anëtarë,

Po filloj me historikun e marrëveshjes. Bisedimet qeveritare në vitet 2015 dhe 2016 mes qeverisë së Republikës Federale Gjermane dhe Republikës së Shqipërisë, rezultuan me angazhimin e qeverisë gjermane për të financuar projektin për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Qytetit Studenti. Angazhimi i qeverisë shqiptare për këtë projekt u konkretizua me nënshkrimin e dy marrëveshjeve qeveritare nga Këshilli i Ministrave, tashmë të ratifikuara me ligjin nr. 69/2016 dhe ligjin nr. 94/2017.

Marrëveshja e parë ka për objekt financimin e objektit me një grand në vlerën 4,5 milionë euro dhe është faza e parë, ndërsa marrëveshja që po diskutojmë sot është faza e dytë dhe është një grand shtesë në vlerën 2 milionë e 32 mijë euro.

Ky financim synon zbatimin e masave të eficiencës së energjisë në rehabilitimin e godinave të konvikteve të Universitetit të Tiranës, ku parashikohet rehabilitimi i 5 godinave. Aktualisht marrëveshja e fazës së parë është në fazën e zbatimit, për të cilën është ngritur komisioni drejtues dhe njësia e zbatimit të projektit.

Objektivat e programit konsistojnë në auditimin energjik të ndërtesave, për të identifikuar konsumin e energjisë dhe masat përkatëse që duhen për të reduktuar konsumin e energjisë; identifikimin e nevojave për rinovimin e ndërtesave në lidhje me gjendjen aktuale të tyre, për të zgjatur ciklin e jetesës së këtyre ndërtesave; reduktimin e konsumit të përgjithshëm të energjisë së ndërtesave, duke synuar që treguesi i performancës së energjisë të jetë të paktën 75 kwh/m² në vit, si dhe llogaritjen e reduktimit të emetimit të dioksidit të karbonit, sipas standardeve të Bashkimit Europian.

Ky projekt do të përfshijë rehabilitimin e 5 godinave dhe kryesisht konsiston në rinovimin e instalimeve sanitare, rinovimin e pajisjeve elektrike, instalimin e paneleve diellore, sistemin e ngrohjes dhe ftohjes, ventilimin, prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar, masat e sigurisë, dhoma të përbashkëta studimi, në mënyrë që të përmirësohet jeta dhe mjedisi i të mësuarit për studentët.

Institucioni përfitues e këtij projekti do të jetë Qyteti Studenti nr. 1 dhe institucioni zbatues do të jetë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Mendohet se nga ky projekt do të përfitojnë rreth 1 mijë studentë.

Projekti parashikohet të fillojë në vitin 2018 dhe do të zgjasë rreth 24 muaj.

Ndërkohë, me qeverinë gjermane jemi duke negociuar edhe një grant të tretë në vlerën 2,9 milionë euro, i cili do të bënte të mundur rehabilitimin e dy godinave të tjera, gjë që do ta çonte në 7 numrin e këtyre godinave.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Kolegë, a keni pyetje për të drejtuar?

Po, zoti Ismet.

Ismet Beqiraj – Përshëndetje!

Meqenëse projekti ka të bëjë me eficiencën e energjisë, unë dua të bëj një pyetje të drejtpërdrejtë: deri tani nga granti janë dhënë rreth 4,5 milionë euro për fazën e parë, por a është bërë ndonjë monitorim në konviktet e përfunduara? Si është efienca e energjisë në këto ndërtesa, duke iu referuar edhe standardit të BE-së, që është 75 kwh/m² në vit?

Alfred Bundo – I nderuar deputet, në lidhje me pyetjen tuaj, dua të them se 4,5 milionë euro të marrëveshjes qeveritare të financimit janë finalizuar. Në fazën që jemi aktualisht është krijuar vetëm komiteti drejtues dhe njësia e zbatimit të projektit, duke përgatitur termat e

referencës për të punësuar konsulentin, i cili do të hartojë projektzbatimin nëpërmjet auditeve energjetike për të vazhduar më pas me fazën e dytë, që është implementimi, pra rehabilitimi. Tani jemi shumë herët për të dhënë një përgjigje të saktë për këtë pikë. Megjithatë, nga eksperiencia jonë me një projekt tjetër të ngjashëm, që lidhet me KfW-në dhe quhet “Promovimi i burimeve të energjive të rinovueshme për Qytetin Studenti nr. 2”, që ndodhet mbrapa Fakultetit të Inxhinierisë, ne po rehabilitojmë 4 godina. Ne jemi në fazën e mbylljes së këtij projekti në dhjetor të këtij viti dhe nga një monitorim që u kemi bërë dy godinave, të cilat kanë përfunduar dhe janë vendosur studentët, kursimi i energjisë është 20 deri 25%. Pra, në qoftë se fatura financiare një vit më parë, para se të implementohej projekti, ka qenë 100 lekë, aktualisht këtë vit, për të njëjtin muaj, fatura elektrike financiare është 80 lekë. Pra, masa e kursimit është 20%.

Qëllimi i këtij projekti dhe i projekteve të tjera në eficiencën e energjisë është që të krijojë një model ekonomik në ndërtesat publike, në mënyrë që ky model ekonomik të projektohet edhe në ndërtesa të tjera.

Qëllim kryesor që qeveria gjermane aplikon për këto projekte prototip është përmirësimi i kushteve ekonomike dhe sociale të studentëve.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Unë kam një pyetje: sa është numri total i studentëve që përfitojnë nga i gjithë projekti? Pra, 1 mijë studentë përfitojnë në këtë fazë të dytë, apo është numri total i studentëve që përfitojnë nga i gjithë projekti?

Alfred Bundo – Numri 1 mijë studentë është vetëm për fazën aktuale ku jemi, për 5 godinat. Momentalisht është në proces negociimi marrëveshja me qeverinë gjermane për një fond shtesë me 12,9 milionë euro për shtimin e dy godinave të tjera. Pra, në total numri i godinave për Qytetin Studenti nr. 1 është 29. Aktualisht me këtë projekt ne mund të finalizojmë 7 ndërtesa dhe na mbetet një diferencë tjetër, për të cilën qeveria shqiptare ka interes që ta zhvillojë dhe më tej këtë projekt. Është pjesë e axhendës së protokollit të bashkëpunimit midis qeverisë shqiptare dhe qeverisë gjermane, që të shikohet mundësia oportune e financimit edhe të pjesës tjetër të ndërtesave, nëpërmjet formës së ndonjë kreditimi me kushte kredie të butë.

Milva Ekonomi- Faleminderit!

Fadil Nasufi - Drejtori dha një shpjegim të qartë të përfitimeve nga ky projekt, ndërkohë ne në marrëveshjen e parë kemi diskutuar nga pikëpamja ligjore, teknike dhe kemi marrë një informacion shumë të plotë. Kisha një pyetje, për të cilën, pak a shumë, u dha një përgjigje. Ne me këtë gjë jo vetëm që përfitojmë 5 godina dhe 2 të tjera që bëhen 7, por fitojmë

një model me donatorë të tjerë. Ky standard të ndiqet edhe në të gjitha qendrat studentore në Tiranë, në Shkodër, në Elbasan, sepse të gjithave u ka ardhur koha që të rinovohen, konviktet të jenë me standarde bashkëkohore, apo bëjmë një model sipas financimit gjerman, pastaj del një donator tjetër dhe e bëjmë sipas modelit zviceran, pra sipas kushteve apo marrëveshjeve që nënshkruajmë me palët që financojnë projektet në këtë fushë?

Alfred Bundo - Ky projekt është pjesë e strategjisë së qeverisë shqiptare për të përdorur masat e eficiencës së energjisë në ndërtesat publike, sipas direktivës së BE-së drejt reduktimit të energjisë, që është pjesë e kësaj strategjie. Siç e thashë edhe më parë ky është një model, i cili edhe me donatorët e tjerë është diskutuar dhe ka një koherencë. Pra, nuk është një projekt thjesht bilateral midis dy qeverive; është në përputhje me planin kombëtar të eficiencës së energjisë për të realizuar targetin kombëtar. Ne kemi kontakte të vazhdueshme edhe me donatorë të tjerë, të cilët kanë shprehur interes dhe kanë parashikuar në strategjitë e tyre. Për shembull, qeveria zvicerane nëpërmjet zyrës së Konfederatës Zvicerane ka parashikuar një fond për të aplikuar masat e eficiencës së energjisë në ndërtesat publike, kryesisht për pushtetin lokal që lidhen me rajonin e Tiranës dhe të Durrësit. Në të shkuarën BE-ja nëpërmjet projekteve të bashkëpunimit ndërkuftar, ka aplikuar projekte të tilla me shkollat në zona të caktuara të Shqipërisë. Ne kemi planifikuar një projekt nga BE-ja për 3 bashkitë që lidhen me Gjirokastrën, me Vlorën dhe me Korçën për të aplikuar masa të eficiencës së energjisë në këto ndërtesa publike. Ky është fillimi i një modeli të tillë, i cili do të aplikohet në të gjithë vendin.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Ka ndonjë tjetër?

Almira Xhambulla - Faleminderit, zoti Keri dhe zoti Bundo për informacionet!

Pa diskutim, siç e thanë edhe kolegët, marrëveshje të tilla janë një mundësi shumë e mirë që jepet, sidomos kur bëhet fjalë për një target siç janë të rinjtë, të cilët ndoshta nuk kanë mundësi ekonomike të mjaftueshme për të përballuar një të drejtë që lidhet me banesat private.

Dua të di, ndoshta nuk ma jepni ju dot këtë përgjigje, mund të ishte një përfaqësues nga bashkia, në lidhje me impaktin direkt që ka projekti në drejtim të rritjes së numrit të kërkuesve dhe të banorëve që janë në Qytetin Studenti. A kanë ndikuar projekte të tilla në rritjen e interesit apo të numrit të studentëve që duan të vazhdojnë të jetojnë në godinat e Qytetit Studenti?

Alfred Bundo -Këtë informacion mund ta sigurojmë nga përfituesi, që është Bashkia e Tiranës dhe mund t'ju adresojmë juve.

Almira Xhambulla - Aty do të matej direkt edhe impakti që ka, përpos të gjithë vlerës që lidhet me energjinë e rinovueshme dhe gjithçka tjetër që lidhte me këtë aspekt.

Milva Ekonomi – Po, zoti Çela.

Bujar Çela - Unë kam një pyetje shumë të thjeshtë: ky investim i qeverisë gjermane në bashkëpunim me qeverinë shqiptare, ku në fund fare qëllimi është t'u përmirësojmë kushtet studentëve, a do të ketë efekt në tarifat që do të paguajnë studentët, pasi të bëhen këto investime? A do të rritet çmimi i pagesës? Jam i sigurt se kërkesa do të rritet, do të ketë kushte më të mira, më të ngrohta, më të ajrosura, por familjarët e këtyre studentëve, a do të përballen me një kosto të re?

Faleminderit!

Alfred Bundo – Sigurisht, kostoja në investime të tilla kaq të mëdha e me standarde kaq të larta, afektohet, por jo në një masë, e cila të jetë e konsiderueshme dhe e papërballueshme për buxhetin e studentëve. Duhet theksuar edhe një gjë: si modele të reja, të cilat kanë infrastrukturë shumë moderne, sidomos me projektin që po aplikojmë me Qytetin Studenti numër 2, nëpërmjet këtij projekti, qëllimi i qeverisë gjermane dhe i joni është të jetë model jo vetëm nga pikëpamja ekonomike, por edhe një model i sjelljes së studentëve, përkundrejt të gjitha parimeve të eficiencës së energjisë. Pra, e gjithë kjo teknologji, këto standarde të larta që janë aplikuar atje, krijojnë edhe një mënyrë tjetër sjelljeje, që mundëson premisa shumë të mira për të menduar në mënyrë më eficiente.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Normalisht, me standardin aktual, janë me miniapartamente, me një standard shumë të lartë. Megjithatë, qeveria gjermane, për dijeninë tuaj, ka bërë disa vizita me përfaqësues shumë të lartë, të niveleve më të larta të KfW-së. Ky është një projekt, i cili është prototip edhe në Ballkan, një nga më cilësorët.

Milva Ekonomi – Ka pyetje të tjera? Mendojmë se e kemi ezauruar të gjithin? Domethënë, është vazhdimi i një projekti të nisur, krijon një model të eficiencës së energjisë në godinat publike, ka kosto, që përkthehet në një çmim pak më të lartë, por është lehtësisht më e lartë për gjithçka që ndodh. Modeli është i replikueshëm edhe për kërkesa nga donatorë të tjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër!

Bujar Çela – Unë mendoj që relatori të mos e marrë fjalën, sepse shpjegimet ishin shtruese.

Milva Ekonomi – Jeni dakord me këtë procedurë? Jeni dakord? Në rregull! Pra, do të propozojmë që të jetë folës në seancë.

Kolegë, jemi dakord që këtë projektligj ta votojmë në parim? Ka kundërshtim? Abstenim? Jo.

Atëherë kalojmë në votimin nen për nen. Kush është dakord me nenin 1 të këtij projektligji? Të gjithë dakord? Ka kundër? Ka abstenim?

Kush është dakord me nenin 2? Të gjithë dakord? S'ka kundër. S'ka abstenim.

Kalojmë në votim në tërësi.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Ju faleminderit shumë përfaqësuesve të ministrive që ishit present në këtë mbledhje! Edhe ne u informuam pak më shumë dhe kuptuam e çfarë po ndodh.

Faleminderit!

Ju lutem, kolegë, tani le të vazhdojmë të qëndrojmë këtu, sepse kemi edhe dy çështje të tjera në rendin e ditës. Kemi për të miratuar procesverbalin e datës 12 shtator dhe, gjithashtu, kemi për të vendosur disa data në kalendarin që kemi propozuar.

Procesverbalin e mbledhjes së kaluar e lexuat? Kemi rënë dakord për kalendarin dhe kemi thënë se duhet të punojmë në bashkëpunim me opozitën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në lidhje me fillimin e vitit të ri shkollor, ne kemi kërkuar në seancë dëgjimore ministren Nikolla. Jeni dakord të bëjmë një thirrje brenda kësaj jave apo ta thërrasim të hënën e ardhshme?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta thërrasim javën tjetër.

Fidel Ylli – Unë do të thosha se do të ishte mirë që në dëgjësë të ishte edhe opozita. Kështu, le t'i japim kohë një çikë më shumë, që të jetë edhe opozita sepse, në fund të fundit, pa opozitën arsimi nuk mund të bëhet me njërën anë. Kësisoj, mirë është t'u japim pak kohë, të presim të vijnë, sepse e kemi planifikuar qysh më përpara se do ta thërrisnim për fillimin e vitit shkollor. Nëse ata s'vijnë, do të shikojmë, do të marrim një vendim tjetër, që t'i thërrisim vetë pastaj.

Milva Ekonomi – Atëherë, jemi dakord që ta mbajmë kalendarin pa data deri të premten e kësaj jave dhe të premten e kësaj jave komunikojmë sërish të gjithë në grup për të propozuar disa data? Por mbani parasysh se në takimin me ministren me temë se si po fillon

viti i ri shkollor, të ketë mundësi edhe opozita të jetë këtu, pastaj ato të tjerat që janë gjëra pak më të thjeshta, të mund t'i bëjmë pa prezencën e opozitës.

A jeni dakord që të propozojmë një vizitë te RTSH-ja në fillim të javës që vjen? Pra, në varësi të dëgjësës të planifikojmë një vizitë në RTSH, që mund të bëhet të hënën, të martën ose të mërkurën e javës së ardhshme.

Do t'u lëmë detyrë juve të sekretarisë të kontaktoni me RTSH-në. Ndërkohë, ne nuk kemi ndonjë projektligj që është depozituar në Kuvend për ne, përveçse këtij që kishim për dhënie mendimi.

Detyra jonë është të bëjmë dëgjesa dhe të bëjmë aktivitet parlamentar, prandaj unë mendoj që RTSH-ja është e rëndësishme. Gjithashtu, duhet të mendojmë edhe për një datë për vizitë tek Inspektorati i Punës dhe tek AMA.

Atëherë, kolegë, do të ridëgjohemi, do të rishkruhem të premtën për të kuptuar se si do të jetë kalendari ekzakt i punës sonë dhe do të komunikojmë me Arianën dhe me këshilltarët për të parë se si duhet të operojmë.

Dakord?

Faleminderit!

Ismaili do të vazhdojë punën si relator.

Para se ta mbylлим, ka dy gjëra për të shtuar Adelina.

Adelina Rista – Mendoj se duhen thënë dy fjalë për fillimin e vitit të ri shkollor në arsimin parauniversitar.

Dje në të gjithë Republikën kanë hapur portat e dijes të gjitha shkollat, kështu që neve, si komision edukimi, na takon t'u themi suksese të gjithë armatës së mësuesve që kanë marrë përsipër një mision shumë të bukur, por shumë të vështirë, aq të vështirë, sa edhe fisnik, edukimin dhe formimin e brezave të së ardhmes.

E pra, dje startoi viti i ri mësimor 2018-2019 dhe ne, si komision edukimi, mendoj se duhet të përcjellim urimin për një vit të mbarë dhe të suksesshëm. Aq më tepër që sivjet nga klasa e parë deri në klasën e katërt, 190 mijë fëmijë morën librat falas.

Unë dua të them edhe diçka tjetër, që ne, në bashkinë e Fierit, i dhamë librat falas edhe për fëmijët e klasës së pestë. Ishte vendim i këshillit bashkiak të Fierit për t'u dhënë librat falas të gjithë nxënësve të klasës së pestë. Këtë iniciativë të qarkut të Fierit e përqaftuan edhe bashkitë e Patosit dhe Roskovecit, të cilat me vendim të këshillit bashkiak, u dhanë librat falas fëmijëve të klasave të pesta.

Unë thjesht desha të përcjell urimin: “Suksese të gjithë fëmijëve që janë ulur dje të bankat e shkollës, të gjithë prindërve dhe armatës së mësuesve që japin dije në këto shkolla! Suksese!”

Milva Ekonomi – I bashkohemi urimit tuaj.

Faleminderit, Adelinë, që e solle në vëmendje të komisionit!

Mbas këtij urimi kaq të ndier, a mund ta quajmë mbledhjen të mbyllur?

Dakord.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA